



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 01  
Datë: 05/01/2022

Këshilli Drejtues në vazhdimin e mbledhjes së datës 09.12.2021, të mbajtur me datë 15.12.2021, mori vendim që të shpall:

**K O N K U R S**  
**Për përfitimin e bursës universitare për vitin akademik 2021/2022**

**I**  
**Kushtet e përgjithshme**

1. Bursa universitare ndahen për studentët e nivelit të studimeve themelore (baçelor).
2. Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët të cilët i plotësojnë këto kushte:
  - 2.1. Të jenë studentë të rregullt të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës;
  - 2.2. Të jenë studentë të vitit të dytë e më lartë;
  - 2.3. Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;
  - 2.4. T'i kenë dhënë të gjitha provimet e parapara për vitin përkatës të studimeve në afatin e shtatorit të vitit akademik 2020/21;
  - 2.5. Të kenë notë mesatare të studimeve më së paku 9.00 (nëntë pikë zero).
3. Përfundimisht nga pika 2.5, studentët e Fakultetit të Ndërtimtarisë, të Fakultetit Arkitekturës, të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, të Fakultetit Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, si dhe studentët e Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, Departamenti i Matematikës dhe Departamenti i Fizikës, mund të aplikojnë edhe me notë mesatare më të ulët, por jo më pak se **8 (tetë)**.
4. Studentëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e sipërsënuara, shërbimi i studentëve në njësinë akademike përkatëse nuk do t'ua verifikoi në SEMS Fletëparaqitjen e cila u'a mundëson aplikimin për bursë.
5. Studentët të cilët në vitin akademik 2020/2021 kanë pasur statusin e studentit me korrespondencë, nuk kanë të drejtë aplikimi për bursë universitare për vitin akademik 2021/2022.

**II**  
**Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim**

1. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika një (I) e këtij konkursi, aplikimin duhet të bëjnë përmes platformës elektronike SEMS në linkun: [studenti.uni-pr.edu](http://studenti.uni-pr.edu)

2. Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:
  - 2.1. Kërkesa për aplikim (Fletë aplikacioni) i cila shkarkohet pas aplikimit online përmes SEMS.
3. Studenti obligohet që Fletë aplikacionin ta printoj dhe ta dorëzoj në shërbimin e studentëve të fakultetit përkatës, si dëshmi që ka aplikuar brenda afatit të paraparë të konkursit.
4. Fakultetet janë të obliguara që në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë konkurs t'i përgatisin listat e studentëve të cilët i plotësojnë kriteret për fitimin e bursës universitare për miratim nga Këshilli Drejtues i UP-së.
5. Përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave do ta bartin dekanët e njësive akademike.
6. Bursat universitare për vitin akademik 2021/2022 nga rezultatet e arritura të vitit akademik 2020/2021 do t'u ndahen studentëve të nivelit baçelor, të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë konkurs, ndërsa lartësia e bursës është caktuar me vendimin e Këshillit drejtues nr.4/203 të datës 22.12.2021.
7. Nëse gjatë aplikimit paraqiten probleme eventuale teknike, të kontaktohet zyrtari i TI-së në njësinë akademike përkatëse.

### III

#### Afati i aplikimit

1. Aplikimi në linkun [studenti.uni-pr.edu](http://studenti.uni-pr.edu) hapet prej datës **05.01.2022** deri me datë **20.01.2022** në orën **15:30**.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë **05.01.2022**, aplikimi elektronik do të funksionalizohet nga ora 13:00.

### IV

#### Afati i ankesave

Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë përfitimi të bursës universitare dhe nuk janë përfshirë në listën e studentëve përfitues të bursës, kanë të drejtë ankesë në afat prej 48 orësh pas ditës së publikimit të listave.

Ankesat duhet të dorëzohen në zyrën nr.19, në ndërtesën e Rektoratit të UP-së.

### V

#### Publikimi i vendimit

Vendimi do të publikohet në tabelat e shpalljeve të fakulteteve si dhe në ueb-faqen e Universitetit: [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu).

